



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**  
**Nr. 13, datë 25.01.2016**

**PËR**

**MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM  
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 2 dhe pikës 21, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe pikës 4, të nenit 52, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Referuar raportimit periodik të BSHS-së, për periudhën janar – 31 dhjetor 2015, depozituar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 214, prot., datë 12.01.2016, rezulton se pagesat e dëmeve objekt i fondit të kompensimit të kryera gjatë kësaj periudhe nga shoqëria e sigurimit “Ansig” sh.a., janë në vlerën **4,150,955 lekë, ose rreth 12 %**, të detyrimit të përcaktuar në vendimin e Bordit të Autoritetit nr. 12, datë 20.03.2015, dhe vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 13, datë 19.05.2015.

Shoqëria e sigurimit “Ansig” sh.a., është përfshirë si ndërhyrës kryesor në procesin gjyqësor me palë paditëse shoqërinë e sigurimit “Eurosig” sh.a. dhe palë të paditur BSHS-në, me anë të së cilës është ankimuar në Gjykatë vendimi nr. 13, datë 19.05.2015 “Për miratimin e masës së kontributit për Fondin e Kompensimit për vitin 2015”, të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, lidhur me ndarjen e kontributit të Fondit të Kompensimit.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është pranuar kërkesa për pezullim të ekzekutimit të vendimit nr. 13, datë 19.05.2015, të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, si dhe në përfundim të gjykimit me vendimin nr. 10259, datë 28.12.2015, gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë si e pambështetur në ligj dhe në prova.

Në këto kushte, Autoriteti ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që të përmbushet detyrimi nga ana e shoqërisë “Ansig” sh.a. dhe vetëm me përfundimin e procesit të ankimimit do të rishqyrtohen shumat e paguara.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Bazuar në pikën 4, të nenit 52, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, të sanksionohet me gjobë në masën 100,000 lekë, Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë “Ansig” sh.a., për mosplotësim të detyrimit të Fondit të Kompensimit të vitit 2015, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 45, të këtij ligji.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Enkeleda SHEHI**